



## MATERIAL PËR MEDIA

**Parimet e “Dizajnit Univerzal” në krijimin e standardeve dhe indikatorëve për qasje në ndërtesa dhe shërbime publike, me qëllim të shmangies së diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, si një nga qëllimet e Konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.**

Realiteti sot në Kosovë është se në të gjenden bariera të shumta arkitektonike, ndërsa ndërtimi dhe renovimi i objekteve publike në pronë shtetërore apo private duhet të ofrojë mundësi për qasje të të gjithë shfrytëzuesve të shërbimeve, ngase në të kundërtën do të vazhdojë të paraqitet diskriminim në dizajnimin hapësinor, që paraqet bariera për qasje të personave me aftësi të kufizuara dhe atyre ua cungon lirinë e tyre të lëvizjes.

Gjatë viteve të 70-a në SHBA kanë filluar të zbatohen parimet e “Dizajnit Univerzal” apo “Dizajnit për të gjithë”, që sot zbatohet në të gjitha shtetet dhe që do duhej të ofrojnë standarde dhe indikatorë minimal për një ndërtim që është i qasshëm për të gjithë qytetarët, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, personat në moshë, ëmat me fëmijë apo shtatëzënat, blerësit me shporta të rënda apo edhe personat me aftësi përkohësisht të kufizuara.

E drejta e qasjes në ndërtesa zyrtare, transport dhe komunikacion është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe ka ndikim të drejtpërdrejt në lirinë e lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara, luftën kundër diskriminimit dhe dhunës ndaj këtij grupi të qytetarëve.

Përmes strukturave përgjegjëse shtetërore, përmes ligjeve dhe masave tjera administrative, duhet të zhvillojmë dhe nxisim parimet e “Dizajnit Universal” në arkitekturë, për të mundësuar qasje në ndërtesat dhe shërbimet e hapura për publik, apo të parapara për publikun; dhe gjithashtu të sigurojë që personat privatë dhe ndërmarrësit që ofrojnë shërbime dhe mbajnë objekte publike të marrin parasysh të gjitha aspektet e mundësive të barabarta sa i përket qasjes së personave me aftësi të kufizuara.

“Ndërtimi i mençur” paraqet një proces të thjeshtësuar të ndërtimit që planifikon paraprakisht qasjen e personave me aftësi të kufizuara në kornizë të planifikimit hapësinor, me ç’ rast arrihen kursime për shkak të shmangies së shpenzimeve të adoptimit dhe rindërtimit të tyre në të ardhmen.

Duke kombinuar forcimin e ligjeve, ngritjen e vetëdijes publike dhe planifikimin hapësinor në kornizë të zbatimit të parimeve të “Dizajnit Universal”, mund të arrijmë deri tek një koncept i mundësive të barabarta sa i përket qasjes në Kosovë.

Ndërtimi dhe zhvillimi i mundësive të barabarta sa i përket qasjes, ka ndikim të drejtpërdrejt në mbrojtjen e drejtave të njeriut, ndërtimin e kapaciteteve të turizmit, ngritjen e nivelit të punësimit mes personave me aftësi të kufizuara, uljen e varfërisë, përmirësimin e qasjes ndaj arsimit, përmirësimin e lirisë së lëvizjes dhe zvogëlimin e nivelit të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Puna shumëdisiplinare e ekspertëve nga fusha e arkitekturës, urbanizmit, transportit, dizajnit dhe ligjvënies, si dhe marrja parasysh e nevojave të ndryshme që nga fillimi i planifikimit, me qëllim të krijimit të mundësive të barabarta për qasje dhe shfrytëzim të objekteve të ndërtuara, produkteve dhe shërbimeve, do të mundësojë në të ardhmen ndërtimin e qyteteve që mundësojnë qasje për të GJITHË qytetarët e Kosovës, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Prishtinë, 14. shkurt, 2007.

Hiljmnijeta Apuk